

**ЛОКАЛЕН АКЦИСКИ ПЛАН ЗА ЕКОНОМСКО ЈАКНЕЊЕ
НА ЖЕНИТЕ ВО ОПШТИНА БИТОЛА**

2016-2017

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË
GRAVE NË KOMUNËN E MANASTIRIT**

2016-2017

**LOCAL ACTION PLAN FOR ECONOMIC EMPOWERMENT
OF WOMEN IN THE MUNICIPALITY OF BITOLA**

2016-2017



Plani lokal i veprimit për fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Manastirit 2016-2017

Projekt financiarisht i mbështetur nga:
Ambasadës e Britanike në Shkup

Projekti i realizuar nga:
Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

Shkup, Nëntor 2015

Ambasada Britanike në Shkup ka mbështetur përgatitjen e këtij publikimi në kuadër të projektit “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna”. Përmbajtja e këtij materiali nuk pasqyrojnë domosdo qëndrimet apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

Publikim:

Plani lokal i veprimt për fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Manastirit 2016-2017

Botues:

Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

Rr.„Vukovarska“ 23-1/2

1000, Shkup

P.O.Box 1090/1010

Tel: + 389 (0)2 2614 641; + 389 (0)2 2611 130

e-mail: antico@t-home.mk; contact@antiko.org.mk

www.antiko.org.mk

Facebook: WCI.ANTIKO

Twitter: WCI_ANTIKO

Redaktor:

Gjyner Nebiu

Irina Hadji Mitova

Përkthimi dhe lektorimi në shqip:

Bashkim Bakiu

Përkthimi dhe lektorimi në anglisht:

Daniela Brajkovska

Dizajni, përgaditja teknike dhe shtypi:

Magna Sken Shkup

Tirazhi:

150 egzemplar

Tirazh që jepet falas/ jokomercijal

Listë e shkurtesave:

APRM – Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë

APFBZhR – Agjencia për Përkrahjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

OQ – Organizatat Qytetare

LMB – Ligji për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat

KMB – Komisioni për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat

MPPS – Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale

PVKBGj – Plani i veprimit kombëtar për barazi gjinore 2013-2016

1. HYRJE

Maqedonia është shtet demokratik e social, në të cilën të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, ndaj një nga vlerat themelore të saj është respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve të saj.

Pozita juridike dhe statusi i grave në Republikën e Maqedonisë janë të rregulluar me Kushtetutë - si akt më i lartë juridik në vend, si dhe në shumë ligje në të cilat është inkorporuar perspektiva gjinore. Përveç me legjislacionin e brendshëm, këto çështje janë rregulluara edhe me marrëveshje ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar dhe ratifikuar, e të cilat, sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, janë pjesë e sistemit tonë juridik.

Korniza juridike për barazi gjinore

Maqedonia ka një kornizë solide ligjore dhe strategjike për promovimin dhe mbrojtjen e mundësive të barabarta, kurse të një rëndësie të veçantë janë: Ligji për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Kodi Zgjedhor, si dhe Ligji për marrëdhënie pune, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e fuqizimit ekonomik të grave dhe reduktimin e varfërisë dhe shkallës së lartë të papunësisë në mesin e grave.

Duhet të theksohet edhe sjellja e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2013-2020, e miratuar nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në të cilën janë përcaktuar prioritetet strategjike sipas sferave dhe Plani kombëtar i veprimit për Barazi Gjinore 2013-2016, i cili ndër të tjera i përcakton edhe objektivat strategjike specifike për përmirësimin e nivelit të barazisë gjinore në sferat prioritare tematike.

Mekanizmat kombëtarë për avancimin e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë

Republika e Maqedonisë ka vendosur mekanizma kombëtarë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në nivel qendror dhe lokal. Në nivel kombëtar, MPPS është ministria përgjegjëse, në kuadër të së cilës drejtpërdrejt përgjegjës janë Sektori për mundësi të barabarta dhe këshilltari shtetëror për mundësi të barabarta.

Njëherësh, në MPPS, sipas LMB, ka një nëpunës shtetëror- përfaqësues juridik për të provuar trajtimin e pabarabartë në bazë të gjinisë, i cili ka për detyrë të kryejë procedurë për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të gjinisë për veprimet e ndërmarra nga subjektet në sektorin publik, por dhe në atë privat, në përputhje me nenin 3 të Ligjit në fjalë.

Sipas LMB (Ligjit për mundësi të barabarta) në të gjitha ministritë nga radhët e nëpunësve civilë ka të emëruar nga një koordinator dhe zëvendës koordinator për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, të cilët me ligj i kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë, ku janë përgjegjës për aplikimin e perspektivës gjinore në ministrinë përkatëse për zbatimin e Strategjisë dhe të gjitha dokumenteve tjera strategjike nga sfera e barazisë gjinore. Ata për aktivitetet e ndërmarra kanë për obligim të dorëzojnë raport vjetor në MPPS.

Në kuadër të strukturës së mekanizmave kombëtarë për barazi gjinore, rol të rëndësishëm luan edhe Komisioni për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë. Së bashku me Klubin e deputeteve, këto organe paraqesin mekanizma për zbatimin e

perspektivës gjinore në organin më të lartë ligjvënës për krijimin e politikave dhe vendimmarrjen.

Mekanizmat gjinorë në nivel lokal në kuadër të institucioneve janë të përbërë nga strukturat e mëposhtme: Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (në kuadër të këshillave të qeverisjes vendore, të përbërë nga këshilltarë me mandat 4 vjeçar) dhe koordinatorët për mundësi të barabarta për gratë dhe burra (nëpunësit shtetërorë). Duhet të theksohet se legjislacioni parashikon një rol të rëndësishëm për qeverisjen vendore në përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore.

Edhe përkundër vendosjes së kornizës ligjore dhe mekanizmave për barazi gjinore, megjithatë, në realitet ekziston një hendek i madh midis barazisë së deklaruar ligjore dhe pozitës reale të gruas në shoqëri. Kundrejt progresit të arritur, gratë mbesin në gjendje jo të lakmueshme në krahasim me meshkujt në shumë sfera. Një nga sferat më të rëndësishme në të cilën dallimet në pozitën e burrave dhe grave mbetet e rëndësishme është ekonomia: gratë ballafaqohen me qasje të vështirësuar dhe shpesh përballen me diskriminim në bazë të gjinisë në tregun e punës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e fuqizimit të pozitës ekonomike të gruas për arritjen e barazisë afatgjatë gjinore dhe të qëndrueshme, Iniciativa qytetare e grave ANTIKO e ka realizuar projektin “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna” në bashkëpunim me Komunën e Manastirit dhe atë të Kërçovës, projekt ky i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Maqedoni. Qëllimi kryesor i projektit është të dizajnohet një model dhe të ndërmerret një qasje participative në formë të pilot projekti që do të bazohet në dëshmi në krijimin e politikave efektive për fuqizimin ekonomik të grave.

Ky synim del drejtpërdrejt nga APFBZhR, synimi strategjik 2.3: Pilot politika të vendosura për tejkalimin e barrierave/pengesave dhe rritja e punësimit të grave, posaçërisht në arritjen e rezultateve të parashikuara, si vijon: 2. Qasje dhe kushte të përmirësuar për gratë në fillimin dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, 3. Qasje e përmirësuar e grave në politikat për punësim, 4. Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë në tregun e punës.

Projekti ka mundësuar që Komisioni për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat (KMB) i Komunës së Manastirit, përfaqësuesit e institucioneve publike relevante, organizatat qytetare lokale, përfaqësuesit e sektorit të biznesit dhe gratë e papuna së bashku t'i identifikojnë masat e nevojshme për fuqizimin e pozitës ekonomike të gruas në Komunën e Manastirit. Rezultat i këtyre përpjekjeve dhe aktiviteteve të përbashkëta është ky plan veprimi lokal për fuqizimin e grave në Komunën e Manastirit për periudhën kohore 2016-2017.

2. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT LOKAL PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE NË KOMUNËN E MANASTIRIT

Plani i Veprimit është përpiluar në bazë participuese, me përfshirjen e të gjitha palëve në përcaktimin e gjendjes faktike dhe në zhvillimin dhe planifikimin e masave për forcimin e pozitës ekonomike të grave në komunë:

Para përgatitjes së Planit të Veprimit, gjendja faktike në komunën e Manastirit u identifikua përmes hulumtimeve të gjera të bazuara në tri burimeve të informacionit:

Metoda e grupeve të fokusit është përdorur për të fituar njohuri në punën e institucioneve përkatëse vendore (njësitë komunale dhe rajonale) sa i përket zhvillimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve të ndjeshme gjinore. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile ka mundësuar të shqyrtohet roli dhe potenciali i tyre për barazi gjinore, me fokus të veçantë fuqizimi ekonomik i gruas në Komunën e Manastirit.

Nëpërmjet studimit në terren, që përfshiu 150 gra të papuna nga pjesët rurale dhe urbane të Komunës së Manastirit u fituan informacione në lidhje me përvojat, mendimet dhe nevojat e grupit të synuar.

Burimi i tretë janë informacionet sekondare, respektivisht të dhëna nga studimet e mëparshme, analiza e legjislacionit dhe informata të publikuara nga institucionet kompetente.

Të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e studimit të përgjithshëm janë dhënë në “Raportin e hulumtimit: Mundësitë dhe pengesat për përfshirjen e grave në tregun e punës në Komunën e Manastirit”, i botuar si publikim i veçantë dhe bashkangjitur Planit Lokal të Veprimit.

Në hapin e ardhshëm, janë realizuar tri cikle trajnimi me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara mbi temat e mëposhtme: Krijimi i politikave të përgjegjshme gjinore dhe buxhetim për organet e vetëqeverisjes lokale, Vlerësimi i ndikimit të legjislacionit dhe Monitorimi dhe vlerësimi i politikave publike. Si mbështetje shtesë është shtypur edhe “Udhëzuesi: Politikat gjinore të përgjegjshme = drejtësi sociale”, në të cilin janë paraqitur tekste që shkojnë në drejtim të përmirësimit të njohurive dhe aftësive në sferat që ishin subjekt i tri trajnimeve të realizuara.

Hapi i tretë ishte realizimi i një punëtorie participative për zhvillimin dhe planifikimin e planit të veprimit. Punëtorja u mbajt më nëntor të vitit 2015 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit publik, civil dhe të biznesit, si dhe me përfaqësuese të grave të afta të papunë. Gjetjet kryesore të studimit të mësipërm janë përdorur si hyrje për diskutim. Procesi i punës u lehtësua në një mënyrë që të lejojë përfshirjen e perspektivave, interesave dhe nevojave të ndryshme të pjesëmarrësve të cilët morën pjesë në mënyrë aktive në propozimin dhe përcaktimin e masave, aktiviteteve dhe hapave të nevojshme. Zgjidhjet e prezantuara në këtë Plan veprimi bazohen në burimet dhe mundësitë e disponueshme lokale, kurse i marrin parasysh kufizimet dhe vështirësitë me të cilat aktorët e përfshirë ballafaqohen në punën e tyre të përditshme. Siç u përmend, vëmendje e veçantë i është kushtuar harmonizimit të zgjidhjeve me përcaktimet aktuale ligjore dhe strategjike të autoriteteve kombëtare dhe lokale dhe për lidhjen e tyre sinergjike me përpjekjet e tyre në fushën e promovimit të barazisë gjinore dhe çështjeve të tjera relevante.

Konsensusi i arritur dhe mirëkuptimi i ndërsjellë gjatë përpilimit të Planit ndërmjet pjesëmarrësve të sektorëve të ndryshëm janë bazë solide për zbatimin e tij të tërësishëm dhe i rrit shanset për arritjen e synimeve të përcaktuara të përbashkëta.

3. SYNIMET DHE AKTIVITETET PRIORITARE

Qëllimi kryesor i këtij Plan veprimi është përforsimi i pozitës ekonomike të grave në Komunën e Manastirit.

Përforsimi i pozitës ekonomike i grave do të kontribuojë në avancimin e

zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të Komunës. Mundësitë e barabarta dhe barazia gjinore do të mundësojnë përfshirjen e grave në ngjarjet kryesore shoqërore dhe në rritjen e kontributit të tyre në mirëqenien e komunës.

Pritet që ky Plan Lokal i Veprimit t'i arrijë synimet strategjike, si vijon:

Synimi strategjik 1. Qasje e lehtësuar e grave në tregun e punës

Ky qëllim do të arrihet përmes aktiviteteve dhe rezultateve si vijon:

1.1. Aftësia e shtuar e grave për përshtatjen e nevojave të tregut të punës

Nga njëra anë, në bashkëpunim me APRM dhe organizatat qytetare, KMB do të sigurojë këshillim karriere për gratë e papuna. Do të sigurohet Zyra dhe persona profesionalë që do të ofrojnë këshillim karriere për gratë e papuna, në pajtim me kërkesat e tregut dhe afiniteteve, aftësive dhe interesave të tyre personale. Organizatat qytetare do ta informojnë grupin e qëllimit për shërbimin që është në dispozicion. Në mënyrë shtesë do të realizohen edhe dy punëtori me gratë e papuna, që t'i jepet rëndësi e duhur këshillimit të karrierës dhe të sigurohen këshilla në drejtim të rritjes së punësimit të tyre.

Nga ana tjetër, do të përpilohet dhe emetohen një videoklip për nxitjen e praktikës, që do të ndikojë në motivimin e punëdhënësve dhe grave të papuna për shfrytëzimin e kësaj mundësie. Videoklipi do t'u vë theks të veçantë përfitimeve për të dyja palët. Po ashtu, do të vendoset edhe bashkëpunim me TV stacionet që të sigurohet emetimi i këtij videoklipi.

1.2. Numri i zvogëluar i shpalljeve me elemente diskriminuese

Do të organizohet fushatë për përmirësimin e transparencës në procedurat e punësimit. Përmes tribunave dhe distribuimit të fletëpalosjeve/broshurave do të theksohet rëndësia e transparencës në procesin e regrutimit të të punësuarve kualitativë.

KMB dhe organizatat qytetare do t'i ndjekin shpalljet e punësimit të shpallura përmes APRM, medimeve, agjencive të punësimit dhe ngjashëm dhe do të përpilohen analiza për harmonizimin e tyre me legjislacionin ekzistues për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Raporti do të përmbajë rekomandime për punëdhënësit, të bazuara në praktikën e mira dhe do të promovohet publikisht.

Në bashkëpunim me APRM, organizatat qytetare dhe Odën Ekonomike do të përpilohet, shtypet dhe promovohet publikisht një Udhëzues për punësimin efektiv të bazuar në mundësi të barabarta. Udhëzuesi do të ofrojë argumente se mundësitë e barabarta nxitin punësimin me profit dhe do të përmbajë këshilla praktikë për punëdhënësit sesi të sigurohen mundësitë e barabarta për të gjithë gjatë punësimit dhe punës së përditshme. Do të përfshihen shembuj të praktikave të mira që e zbatojnë parimin e mundësive të barabarta në punës të përditshme.

1.2. Shfrytëzimi i shtuar i masave qeveritare për punësim nga ana e grave

Në bashkëpunim me APRM dhe organizatat qeveritare, KMB do të fillojë inicijet dhe kryejë hulumtime dhe analiza mbi informimin e grave të papuna për masat e propozuara qeveritare për punësim. Ndërgjegjësimi dhe nevojat e grave në zonat rurale do të përfshihen në hulumtim. Raporti i hulumtimit do të shtypet dhe promovohet. Ky raport do të përmbajë rekomandime për sektorin publik dhe civil për punën e koordinuar që synon përmirësimin e ndërgjegjësimit të grave të papuna.

Në bazë të të gjeturave të Raportit në fjalë, do të kryhen aktivitete për afirmimin dhe promovimin e mundësive që i ofrojnë masat qeveritare

për punësim. Ky aktivitet do të jetë me karakter fushate dhe do të zhvillohet nëpërmjet disa formave, si: tribuna, punëtori, përpilimi dhe distribuimi i fletëpalosjeve, shpallje, pjesëmarrje dhe bashkëpunim me mediumet etj. KMB, APRM dhe organizatat qytetare do të marrin pjesë bashkërisht në realizimin e këtyre hapave konkretë.

1.4. Shtimi i besimit në APRM si servis i qytetarëve për punësim

Do të zbatohen masa për përforsimin e vetëdijes së qytetarëve për rolin e APRM-së si servis për punësim. Kujdes do t'u kushtohet atyre personave që kërkojnë punë e që nuk janë aktiv dhe grave të papuna nga zonat rurale me qëllim të përfshirjes së tyre. Qytetarëve dhe qytetareve të interesuar do t'u sqarohet roli i APRM përmes video-klipit dhe një sërë ngjarjesh informative, si dhe pjesëmarrja në mediumet lokale. Parashikohet edhe pjesëmarrja e drejtpërdrejt e grave që sapo janë punësuar, që punësimin e tyre e kanë realizuar me ndërmjetësim të APRM-së, si shembuj pozitivë.

Synimi strategjik 2. Numri i rritur i grave sipërmarrëse

Do të ndërmerren masa që të nxitet vetëpunësimi, pra fillimi i biznesit personal dhe regjistrimi i grave nga zonat rurale me veprimtari në sferën e bujqësisë. Këto aktivitete do të realizohen në bashkëpunim me organizatat qytetare, APRM dhe APFBZhR, që do t'i prezantojnë mundësitë ekzistuese. Me këtë aktivitet pritet që të arrihen këto rezultate:

2.1. Shtimi i interesit i grave të papuna për hapjen e biznesit personal (vetëpunësim)

Dy herë në vjet do të organizohen Ditë të Hapura për gratë-sipërmarrëse, me qëllim që të promovohen praktikatat e mira dhe shembujt pozitivë. Këto ngjarje do të paraqesin një mundësi të mirë për ndarjen dhe shkëmbimin e informatave dhe përvojave ndërmjet grave të papuna dhe atyre që merren me sipërmarrësi, të cilat kanë themeluar dhe me sukses e udhëheqin biznesin e vet. Posaçërisht do t'i kushtohet rëndësi prezantimit të shembujve pozitivë të grave që merren me sipërmarrësi të cilat biznesin e tyre personal e kanë filluar me përkrahjen e masave qeveritare (apo tjera) për vetëpunësim.

KMB në bashkëpunim me organizatat qytetare dhe me sektorin e biznesit, do të ofrojë përkrahje të start-up bizneseve të grave. Atyre që janë të interesuara do t'u ofrohet trajnim për zhvillimin e planeve të biznesit. Po ashtu, do të organizohet konkurs për start-up planet më të mira, ku pjesëmarrësve që kanë plane biznesi do të fitojnë shpërblime në të holla (pra, përkrahje financiare për realizimin e idesë së tyre) dhe promovim.

2.2. Shtimi i numrit të grave – që do të regjistrohen në veprimtarinë e bujqësisë

Do të organizohen ngjarje promovuese për informimin e qytetarëve dhe qytetareve nga zonat rurale për mundësitë ekzistuese për gratë që do të regjistrojnë veprimtarinë e bujqësisë. Po ashtu, do të ofrohet edukim-trajnime praktikë për hapat e nevojshëm që gratë duhet t'i ndërmarrin që të regjistrojnë këtë veprimtari dhe për paraqitjen e tyre për shfrytëzimin e subvencioneve shtetërore nga kjo veprimtari.

Synimi strategjik 3. Rritja e mundësive për avancim në karrierë për gratë

Do të ndikohet në vetëdijen publike, që shpeshherë ndikon në kufizimin e ngritjes në karrierë të grave. Në të njëjtën kohë do të nxitet diskutimi për përkrahjen e nevojshme që u nevojitet grave të punësuar për avancimin e

tyre në karrierë. Arritja e këtij synimi pritët që realizohet përmes rezultateve si vijon:

3.1. Ngritja e vetëdijes për nevojën dhe përparësitë në sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat

Do të organizohet një mini-fushatë për tejkalimin e stereotipave dhe paragjytimeve ndaj grave nga aspekti i traditës, religjionit dhe etikës. Mediumet lokale do të jenë partnerët kryesorë që do të mundësojnë emetimin e videoklipeve që do të përpilohet vetëm për këtë ngjarje. Do të bëhen dhe distribuohen fletëpalosje. Po ashtu, do të organizohen ngjarje publike për promovimin e shembujve pozitivë – gratë që kanë bërë karrierë të suksesshme, ku në këto ngjarje do të shkëmbejnë mendime dhe përvoja me qytetarët dhe qytetarët pjesëmarrës.

3.2. Promovimi i nevojës për qasje në serviset për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare

Do të kryhet analizë për nevojën e serviseve në dispozicion për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare (shembull: kopshte me orar pune fleksibil, përkujdesja e anëtarëve të moshuar në familjen më të gjerë dhe ngjashëm). Raporti nga kjo analizë do të përmbajë rekomandime për hapat e nevojshëm për sigurimin e serviseve të kërkuara në nivel lokal. Nga ana tjetër, publiku, dhe në radhë të parë sektori i biznesit, do të informohet për nevojën dhe mundësitë për serviset që janë në dispozicion për përkrahjen e grave të punësuar. Posaçërisht vëmendje do t'u kushtohet subvencioneve qeveritare që janë në dispozicion dhe mundësive për partneritet publiko-privat nga kjo sferë. Këto aktivitete do të realizohen në bashkëpunim të drejtpërdrejt me Odën Ekonomike dhe sektorin e biznesit.

Synimi strategjik 4. Përmirësimi i bashkëpunimit midis aktorëve kryesorë për barazi gjinore

Përforsimi i bashkëpunimit do të mundësojë koordinim dhe sinergji në veprim me Komunën e Manastirit, institucionet publike në komunë (njësitë lokale dhe rajonale të institucioneve shtetërore) dhe me shërbimet e sektorit civil për barazi gjinore në nivel lokal. Ky përmirësim i KMB do të nxisë bashkëpunimin me sektorin e biznesit. Prandaj, pritët që ky synim të realizohet përmes rezultateve të arritura, si vijon:

4.1. Bashkëpunim i përmirësuar ndërmjet sektorit civil dhe publik për barazi gjinore

KMB do të mbajë takime të rregullta të përfaqësuesve të administratës komunale të institucioneve publike në komunë (njësitë lokale dhe rajonale të institucioneve shtetërore) dhe sektorit civil, që janë aktiv në sferën e barazisë gjinore. Po ashtu, KMB do të sigurojë përfshirjen e organizatave të qytetarëve në vendimmarrje në nivel komunal për çështje të ndjeshme gjinore, përmes konsultimeve dhe debateve. Masa e tretë përfshin përforsimin e kapacitetit të KMB, Komunës së Manastirit dhe institucioneve publike për përgatitjen, zbatimin dhe administrimin e projekteve të financuara me fondet e BE. Me përkrahjen e ekspertëve nga jashtë do të përpilohen projekte që do të parashtrohen te mekanizmat për financim me BE-në. Si shtesë, institucionet dhe organizatat qytetare të trajnuara në mënyrë të pavarur do të përpilojnë projekte tjera (me përkrahje të ekspertëve), që do të mundësojë zbatimin praktik të ditorive të fituara. Të gjitha projektet do të realizohen në partneritet me organizatat qytetare që do të marrin pjesë në zbatimin e tyre.

4.2. Promovimi i përmirësuar i KMB

Për promovimin e aktiviteteve të veta, KMB do të ndërmarrë disa aktivitete, si: do të përpilohen fletëpalosje promovuese për sqarimin e rolit dhe detyrave të Komisioni. KMB do të vendos praktikën për përpilimin e e-informatorit tremujor që do të distribuohet në një rreth më të gjerë të aktorëve të interesuar në nivel lokal dhe kombëtar. Një pjesë e aktiviteteve promovuese do të zbatohen në rrjetet sociale (Facebook). Përfundimisht, KMB do të vazhdojë me bashkëpunimin e vendosur mirë me mediumet lokale për prezantimin e aktiviteteve personale, duke përfshirë aktivitetet e parapara me këtë plan veprimi.

4. PLANI I IMPLEMENTIMIT

KMB do të jetë përgjegjëse për zbatimin e planit lokal të veprimit për përforsimin e pozitës ekonomike të gruas. Participimi, partneriteti me palët kryesore të interesuara, posaçërisht me organizatat relevante qytetare, dhe transparenca do të jenë parimet udhëheqëse gjatë planifikimit dhe zbatimit të hapave konkretë operativ.

Si hap i parë KMB do t'i propozojë Këshillit të Komunës së Manastirit që të miratojë Planin lokal të veprimit, që do të mundësojë alokimin e resurseve të nevojshme komunale dhe mjeteve financiare. Me këtë do të sigurohet korniza e nevojshme institucionale për zbatimin e Planit dhe arritjes së qëllimeve të synuara.

Vëmendje e veçantë gjatë zbatimit të këtij Plani do t'i kushtohet koordinimit të aktiviteteve me programet tjera ekonomike dhe programeve dhe përpjekjeve tjera relevante të Komunës së Manastirit dhe institucioneve publike lokale. Me këtë do të sigurohet veprim sinergjik dhe arritje më të mëdha.

KMB do të sigurojë transparencë në opinion lidhur me zbatimin e këtij Plani përmes kontakteve të drejtpërdrejta me palët e interesuara dhe në bashkëpunim me mediumet lokale.

5. KORNIZA KOHORE PËR ZBATIMIN E PLANIT

Plani lokal i veprimit për fuqizimin e pozitës ekonomike të gruas në Komunën e Manastirit do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2016-2017.

Dinamika kohore e aktiviteteve ndaras është prezantuar në pjesën *Pasqyrë e synimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave*, më poshtë në këtë dokument.

Periudha e saktë e zbatimit të aktiviteteve konkrete do të përcaktohet në bashkëpunim me aktorët kryesorë dhe në pajtim me nevojat dhe mundësitë për këtë grup të qëllimit.

6. BUXHETI

Për zbatimin e Planit lokal të veprimit për fuqizimin e pozitës ekonomike të grave në Komunën e Manastirit nevojiten gjithsej 1.900.000 denarë. Pasqyra e mjeteve financiare dhe resurseve të nevojshme tjera për zbatimin e secilit aktivitet janë dhënë në shtojcën *Pasqyrë e synimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave*, më poshtë në këtë dokument.

Përpos buxhetit të Komunës së Manastirit mjetet e nevojshme do të sigurohen nga donatorë të vendit dhe nga jashtë, si USAID, fondet evropiane që janë në dispozicion, UNDP, ambasadat e jashtme në Maqedoni, FSHHM, programi CIVICA etj. Për këtë qëllim, KMB dhe organizatat qytetare të përfshira do të përpilojnë fletëparaqitje (projekte) për mjete. Më tej, pritet që sektori lokal i biznesit, duke përfshirë odën ekonomike rajonale dhe shoqatat tjera të punëdhënësve dhe biznesmenëve, të japin kontribut material dhe, varësisht nga mundësitë, mjete financiare për zbatimin e Planit në fjalë.

Resurset e nevojshme dhe mjetet financiare për zbatimin e secilit aktivitet konkret janë dhënë në shtojcën *Pasqyrë e synimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave*, më poshtë në këtë dokument.

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
Synimi strategjik 1: Qasje e lehtësuar e grave në tregun e punës							
1.1. Përfundimi i aftësisë së grave për përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës	1.1.1. Sigurimi i këshillimit të karrierës	KMB APRM Organizatat qytetare	Në kontinuitet 2016-2017	Zyra (një herë në javë) Hapësirë për mbajtjen e 2 punëtorëve Ekspertë 200,000 denarë për ekspertët dhe për realizimin e 2 punëtorëve	Komuna e Manastirit Organizatat qytetare	50 gra në vjet kanë fituar këshillim karriere 2 punëtorë nga 50 gra Numri i artikujve në mediumet lokale për këshillim e siguruar të karrierës	Raportet mujore për punën e Zyrës për këshillim karriere Raport nga dy punëtorët e mbajtura, duke përfshirë edhe listën e pjesëmarrësve dhe analiza e pyetësorëve
	1.1.2. Promovimi i mundësive për praktikantë përmes përfundimit të videoklipit	Organizatat qytetare	2 vjet 2016-2017	50,000 denarë	Organizatat qytetare Komuna e Manastirit	Është përfunduar videoklip për nxitjen e praktikës Emetimi i videoklipit së paku një herë në javë në TV lokale	Raport për përfundimin e videoklipit Kontratë me TV lokale për emetimin e videoklipit

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
1.2. Reduktimi i praktikave diskriminuuese gjatë punësimit të grave	1.2.1. Fushatë për përmirësimin e transparencës në procedurat e punësimit	Organizatat qytetare Mediimet	6 muaj Janar – qershor 2016	Hapësirë për mbajtjen e tribunave 90.000 denarë për: - ligjëruesit dhe atyre që do të marrin fjalën hyrëse dhe freskimi i tribunave - përpilimi dhe distribuimi i fletëpalosjeve/broshurave	Komuna e Manastirit Organizatat qytetare	Janë mbajtur tre tribuna me nga 30 punëdhënës Është përpiluar fletëpalosje/broshurë në 1.000 ekzemplarë	Raporte nga tribunaat, duke përfshirë edhe listën e pjesëmarrësve dhe analiza e pyetësorëve Raport për përpilimin e fletëpalosjes/broshurës
	1.2.2. Monitorimi i shpalljeve për punësim (të publikuara përmes APRM, medimeve, agjencive të punësimit etj.)	KMB Organizatat qytetare	6 muaj Janar – qershor 2016	120.000 denarë: - për ndjekjen e shpalljeve - ekspertë për analizën e shpalljeve nga aspekti i diskriminimit, - raport i shtypur nga monitorimi Hapësirë për promovimin e raportit	Komuna e Manastirit Organizatat qytetare	Është përpiluar raport/ analizë e shpalljeve të punësimit nga aspekti i diskriminimit Së paku 50 të pranishëm në promovimin e raportit Numri i artikujve mediatik në mediimet lokale për promovimin e raportit	Raport për përpilimin e raportit Lista e të pranishmëve në promovimin e raportit Lista e artikujve në mediimet lokale për promovimin e raportit
	1.2.3. Përpilimi i Udhëzuesit për punësim efektiv në bazë të mundësive të barabarta	APRM Organizatat qytetare Oda Ekonomike KMB	1 vjet Janar-dhjetor 2016	150,000 denarë për: - ekspert për përpilimin e Udhëzuesit, - përgatitja dhe shtypja në 300 kopje Hapësirë për promovimin e Udhëzuesit	KEM ABPM Organizatat qytetare Oda Ekonomike	Distribuimi deri te 300 punëdhënës Lista e të pranishmëve në promovim	Lista e distribuimit të Udhëzuesit Lista e të pranishmëve në promovim

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
1.3. Rritja e shfrytëzimit të masave qeveritare për punësim, nga gratë	1.3.1. Hulimtimi dhe analiza e ndërgjegjësimi të grave të papuna për masat e ofruara qeveritare	Organizatat qytetare APRM, KMB	6 muaj Janar – qershor 2016	60,000 denarë për: - hulimtimes nga jashtë - shfrytëzimi e hulimtimi - freskim në promovimin e hulimtimi Hapësirë për promovimin e raportit të hulimtimi	Komuna e Manastirit (20%) Donatorë – përmes organizatave të qytetarëve - OQ (80%)	Raport i përpiluar nga analiza e ndërgjegjësimi të grave të papuna për masat e ofruara qeveritare Së paku 50 të pranishëm në promovimin e raportit Numri i artikujve mediatik i medimeve lokale për promovimin e raportit	Raport për hulimtimin e kryer Lista e të pranishmëve në promovim Lista e teksteve në medimet lokale për promovimin e raportit
	1.3.2. Afirmimi dhe promovimi i mundësive që i ofrojnë masat qeveritare për punësim (tribuna, punëtori, fletëpalosje, medime)	Organizatat qytetare APRM KMB Medimet	Në kontinuitet 2016-2017	150.000 denarë për: - mbajtjen e tribunave dhe punëtorive, - përpunimi dhe distribuimi i fletëve - shpallje në medime - aktivitete tjera informative të partnerëve kryesorë	Komuna e Manastirit (30%) Donatorë – përmes OQ (70%)	Numri i ngjarjeve të zhvilluara dhe pjesëmarrësve në këto ngjarje Numri i fletëpalosjeve të përpiluara dhe të distribuara Numri i shpalljeve në medimet lokale	Raportet nga ngjarjet, duke përfshirë listën e të pranishmëve dhe analizën e pyetësorëve Raport për përpilimin dhe distribuimin e fletëpalosjeve Kontratë me medimet lokale për publikimin e shpalljeve

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
1.4. Rritja e besimit në APRM si servis i qytetarëve për punësim	1.4.1. Aktivitete për përforcimin e vetëdijes publike për rolin e APRM si servis për punësim	APRM Organizatat qytetare	Në kontinuitet 2016-2017	150.000 denarë për: - përpilimin e videoklipit - mbajtja e dy ngjarjeve informative-12 - shpenzime të rrugës për mbajtjen e ngjarjeve në mjediset rurale - përfshirja e grave të sapo punësuar si shembuj pozitivë - pjesëmarrja në mediumet lokale elektronike etj.	Komuna e Manastirit (30%) Donatorë – përmes OQ (70%)	Përpilimi i videoklipit për rolin e APRM Numri i emetimeve të videoklipit në TV lokale Numri i pjesëmarrjes në mediumet lokale elektronike Numri i ngjarjeve të zhvilluara informative Numri i grave të sapo punësuar si shembuj pozitivë	Raport për përpilimin e videoklipit Kontratë me TV lokale për emetimin e videoklipit Lista e pjesëmarrjeve në mediumet lokale elektronike Raporte nga ngjarjet, duke përfshirë listën e të pranishmeve dhe analizën e pyetësorëve

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
Synimi strategjik 2: Rritja e numrit të grave sipërmarrëse							
2.1. Rritja e interesit të grave të papuna për biznes personal (vetëpunësim)	2.1.1. Organizimi i Ditëve të Hapura për gratë – sipërmarrëse (duke përfshirë promovimin e praktikave të mira	KMB APRM Organizatat qytetare	Dy herë në vjet 2016-2017	Hapësirë 80.000 denarë për: - ftesat - fletëpalosje - freskim (20.000 denarë për ngjarje)	Komuna e Manastirit	4 ngjarje – Ditë të Hapura për gratë – sipërmarrëse Numri i vizitorëve: Së paku 100 për një ngjarje Numri i shpalljeve mediale të ngjarjeve	Raport nga ngjarjet – Ditë të hapura për gratë – sipërmarrëse Numri i vizitorëve Fotografi nga ngjarjet Numri i artikujve mediatike për ngjarjet
	2.1.2. Përkrahja e start-up bizneseve të grave: selektimi i kandidateve, trajnim për planin e biznesit, shpërblime	KMB Organizatat qytetare Sektori i biznesit	6 muaj Janar – qershor 2016	300.000 denarë për: - shpallje për kandidatet për start-up biznes - trajnime për planin e biznesit (ekspertë, hapësirë, materiale) - manifestimi i ndarjes së shpërblimeve për biznes planet më të mira.	Mjete nga donatorët përmes aplikimit të përbashkët të KMB dhe organizatave të qytetarëve	Numri i kandidateve të paraqitura Numri i kandidateve të zgjedhura të cilat me sukses do ta përfundojnë trajnimin e planit të biznesit Numri i biznes-planeve të realizuara Numri i vizitorëve në ndarjen e shpërblimeve Numri i publikimeve mediale lidhur me ndarjen e shpërblimeve	Raport për paraqitjen dhe zgjedhjen e kandidateve Raport nga trajnimet kryer Raport nga ndarja e shpërblimeve Fotografi Lista e artikujve mediatik për shpërblimet

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
2.2. Rritja e numrit të grave – që do të regjistrohen në veprimtarinë e bujqësisë	2.2.1. Organizimi i ngjarjeve promovuese për mundësitë për gratë që kanë veprimtari bujqësinë	KMB Organizatat qytetare APFBZHR	2 vjet në kontinuitet 2016-2017	Hapësirë 40.000 denarë për: - materiale - freskim - shpenzime rruge Për mbajtjen e 8 takimeve në mjediset rurale (5.000 denarë për një ngjarje)	Komuna e Manastirit Organizatat e qytetarëve (donacione nga donatorët)	8 ngjarje të mbajtura promovuese Së paku 30 gra – pjesëmarrëse në çdo ngjarje	Raporte nga ngjarjet promotive, duke përfshirë listën e të pranishmëve dhe analiza e pyetësorëve Lista e artikujve medial për ngjarjet promovuese
	2.2.2. Edukimi i grave – me veprimtari bujqësinë	KMB Organizatat qytetare APFBZHR	2 vjet në kontinuitet 2016-2017	Hapësirë 120.000 denarë për: - ekspertë - materiale - shpenzime rruge për ekspertët - freskim Për 8 trajnime praktike për gratë – që merren me veprimtari bujqësie	Komuna e Manastirit Organizatat e qytetarëve (donacione nga donatorët)	8 trajnime njëditore praktike të mbajtura për gratë – me veprimtari bujqësinë Së paku 15 gra të trajnuara në çdo trajnim	Raporte nga trajnimet, duke përfshirë listën e të pranishmëve dhe analiza e pyetësorëve

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
Synimi strategjik 3: Rritja e mundësive për avancim në karrierë të grave							
3.1. Ngritja e vetëdijes për nevojën dhe përparësitë në sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat	3.1.1. Fushata mediatiqe (video spot, fletëpalosje) për tejkalimin e stereotipave dhe paragjykimeve ndaj grave (tradita, religjioni, etika)	Organizatrat qytetare KMB	6 muaj Janar – qershor 2016	100.000 denarë për: - përpilimin e videoklipit, - përpilimi dhe distribuimi i fletëpalosjes	Komuna e Manastirit Donatorë ndërkombëtarë që punojnë në barazinë gjinore	Video-klip i përpiluar Emetimi tre herë në ditë në periudhë prej 3 muajve Fletëpalosje e përpiluar dhe distribuuar	Raport për përpilimin e videoklipit Kontratë me TV lokale për emetimin e video incizimit Lista e distribuimit të fletëpalosjes
	3.1.2. Promovimi i shembujve pozitivë – gratë të cilat me sukses kanë bërë karrierën e tyre	KMB Organizatrat qytetare	2 vjet 2016-2017	40.000 denarë për ngjarjet promovuese Shembujt pozitivë – gra që kanë bërë karrierë të suksesshme	Komuna e Manastirit Donatorë ndërkombëtarë që punojnë në barazinë gjinore	Katër ngjarje të mbajtura për promovimin e shembujve pozitivë – gra që kanë bërë karrierë të suksesshme	Raport për ngjarjet e mbajtura promovuese Lista e artikujve mediale për ngjarjet promovuese
3.2. Promovimi i nevojës për serviset që janë në dispozicion për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare, duke përfshirë rekomandime	3.2.1. Analiza e nevojës për servise të disponueshme për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare, duke përfshirë rekomandime	KMB Organizatrat qytetare	6 muaj Janar – qershor 2016	90.000 denarë për: - ekspertë për përpilimin e analizës - hulumtim anketues të grave të punësuar - shtypja e materialit - promovim i raportit	Komuna e Manastirit Donatorë ndërkombëtarë që punojnë në barazinë gjinore	Analizë e përpiluar për nevojën e serviseve që janë në dispozicion për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare Numri i të pranishmëve në promovimin e analizës Numri i artikujve mediale lidhur me analizën	Raport për përgatitjen e analizës Lista e të pranishmëve në promovimin e analizës Lista e artikujve mediale lidhur me analizën

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
3.2. Promovimi i nevojës për serviset që janë në dispozicion për përkrahjen e grave të punësuar në kryerjen e obligimeve familjare	3.2.2. Informimi i bashkësisë së biznesit për nevojën dhe mundësitë për servise të disponueshme për përkrahjen e grave të punësuar, duke përfshirë subvencionet qeveritare për partneritet publiko-privat	KMB Organizatat qytetare Bashkëpunim me Odën Ekonomike	3 muaj Janar-mars 2017	30.000 denarë për: - përpilimin e fletëpalosjes promotive (duke përfshirë pasqyrën e mundësive për përkrahjen për themelimin e serviseve), - ngjarje promotive Hapësirë për ngjarjen promovuese	Komuna e Manastirit Donatorët ndërkombëtarë të cilët punojnë në barazinë gjinore	Fletëpalosja promovuese është shtypur dhe distribuuar në 1.500 ekzemplarë Numri i vizitorëve në ngjarjen promovuese Numri i artikujve media me ngjarjen promovuese	Raport për përpilimin e fletëpalosjes Lista e distribuimit të fletëpalosjes Numri i vizitorëve në ngjarjen promovuese Lista e artikujve media lidhur me ngjarjen promovuese

Qëllimi i dëshruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
Synimi strategjik 4: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë për barazi gjinore							
4.1. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe publik për barazi gjinore	4.1.1. Organizimi i takimeve të rregullta koordinuese	KMB Institucionet publike në komunë Organizatrat qytetare	Në kontinuitet 2016-2017	Hapësira për mbledhjet	Komuna e Manastirit Institucionet publike në komunë	Numri i takimeve të mbajtura koordinuese Numri dhe struktura e pjesëmarrësve në takimet koordinuese	Procesverbale nga takimet koordinuese Lista e të pranishmëve në takimet koordinuese
	4.1.2. Përfshirja e organizatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në komunë lidhur me çështjet e ndjeshme gjinore	KMB Organizatrat qytetare	Në kontinuitet 2016-2017	Hapësira për mbledhjet Persona përgjegjës nga komuna dhe nga organizatat e qytetarëve	Komuna e Manastirit	Organizatrat relevante qytetare janë të përfshirë së paku në 5 procese në vendimmarrjen për çështje të ndjeshme gjinore në komunë Numri i takimeve të mbajtura konsultuese	Procesverbale nga takimet konsultative Lista e të pranishmëve në takimet konsultative
	4.1.3. Përforsimi i kapacitetit të KMB, Komunës së Manastirit dhe institucioneve publike në komunë për përgatitjen, zbatimin dhe administrimin e projekteve të financuara nga BE	KMB Institucionet publike në komunë Organizatrat qytetare	3 muaj Janar-mars 2016	Hapësira për mbajtjen e trajnimit treditör 60.000 denarë për: - trajnuesit - materiale për punës - freskim dhe ushqim	Komuna e Manastirit	Së paku 16 persona nga institucionet publike dhe organizatat e qytetarëve në komunë janë të trajnuar për përgatitjen, zbatimin dhe administrimin e projekteve të financuara nga BE	Raport nga trajnimi i kryer Lista e të pranishmëve të cilët me sukses e kanë kryer trajnimin

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
4.1. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë për çështjet gjinore nga sektori civil dhe publik	4.1.4. Përpilimi i fletëparaqitjeve (projekteve) të përbashkëta për fondet e donatorëve të huaj për çështjet gjinore	KMB Organizatrat qytetare	Në kontinuitet Prill-dhjetor 2016	Hapësira për punëtoritë për planifikimin projektesh participativ 60.000 denarë për: - ekspertë nga jashtë për zhvillimin participativ të projekteve - materiale për punës - freskim dhe ushqim	Komuna e Manastirit	Së paku 4 fletëparaqitje (projekte) të përbashkëta për çështjet gjinore janë realizuar dhe parashtruar te donatorët e huaj	Raporte nga punëtoritë për planifikimin e projekteve participative Lista e pjesëmarrësve në planifikimin e projekteve participative
4.2. Përmirësimi i promovimit të KMB	4.2.1. Përpilimi i fletëpalosjeve provuese për KMB 4.2.2. Përpilimi i e-informatorit tremujor për aktivitetet e KMB 4.2.3. Prezantimi i KMB në rrjetet sociale dhe internet	KMB KMB KMB	Në kontinuitet 2016-2017 Në kontinuitet 2016-2017 Në kontinuitet 2016-2017	10.000 denarë për: - përpilimin e fletëpalosjeve Kompiuter, lidhje interneti Person përgjegjës Kompiuter, lidhje interneti Person përgjegjës	Komuna e Manastirit Komuna e Manastirit Komuna e Manastirit	Është përpiluar fletëpalosje promotive për KMB Është përpiluar e-informatori tremujor për aktivitetet e KMB Është hapur profili i KMB në Facebook Azhurnimi i rregullt i profilit të KMB në Facebook Numri i ndjekësve të profilit të KMB në Facebook	Lista e distribuimit Lista e e-mailave e informatorit tremujor për aktivitetet e KMB Pasqyrë e përmbajtjeve të publikuara në profilin e KMB të Facebook Ndjekja e numrit të ndjekësve të KMB në Facebook

Qëllimi i dëshiruar	Masat dhe aktivitetet e parashikuara	Përgjegjësi e	Korniza kohore	Resurset	Burimet e financimit	Treguesit e suksesit	Aktivitetet për monitorimin e zbatimit
4.2. Përmirësimi i promovimit të KMB	4.2.4. Prezantimi i aktivitetëve të KMB në mediumet lokale	KMB	Në kontinuitet 2016-2017	Anëtarët e KMB Bashkëpunim me mediumet lokale	Komuna e Manastirit	Së paku një herë në muaj anëtarët i prezantojnë aktivitetet e KMB në mediumet lokale	Lista e pjesëmarrjeve në mediumet lokale të anëtarëve të KMB

Women's Civic Initiative ANTIKO

„Vukovarska“ 23/1-2, 1000 Skopje
P.O. Box 1090/1010

Tel: ++ 389 (0)2 2 614 641; ++ 389 (0)2 2 611 130

e-mail: antico@t-home.mk ; contact@antiko.org.mk

www.antiko.org.mk

Facebook: WCI.ANTIKO

Twitter: WCI_ANTIKO



British Embassy
Skopje



Женска граѓанска иницијатива
Initiative qytetare e femërore
Women's Civic Initiative

